



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.377/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Veton Berisha – Kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për rinumërim të 198 vendvotimeve, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në rinumërimin nga ana e KQZ-së për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuar ankesa Anr.377/2019, e datës 23.10.2019, e parashtruar nga Veton Berisha – Kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me anë të së cilës ka kërkuar, që të urdhëroj KQZ-në për rinumërim të 198 vendvotimeve, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në rinumërimin nga ana e KQZ-së, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.377/2019, të parashtruar nga Veton Berisha, në të cilën thekson se gabimi teknik i paraqitur në FPR më së shumti e ka dëmtuar subjektin tonë PLE, sepse kemi qenë të vetmit subjekt që i ka munguar rubrika, parashtruesi i ankesës më tutje kërkon nga PZAP, që në afat sa më të shpejt të vendos dhe të rekomandoj KQZ-në dhe QNR-në, që të rinumëroj edhe 198 vendvotime të cilat janë të propozuara nga ne, propozimet tona i gjeni të bashkangjitura në tabelën përcjellëse të kësaj kërkesë ku secili vendvotim e ka përshkrimin e saktë të gabimit teknik të realizuar gjatë bartjes së të dhënave në ditën e zgjedhjeve me datë 06.10.2019.

Në përgjigje në ankesë të datës 24.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se secili Formular i Rezultateve para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Formularët të cilët nuk kanë përputhje matematikore nuk mund të procedohen si të rregullt (këtë nuk e lejon sistemi i përpunimit të të dhënave), dhe i njëjti do t'i nënshtrohet auditimit në QNR dhe varësisht nga rezultati, eventualisht edhe rinumërimin. Ndërsa lidhur me pretendimet e palës ankuese, udhëheqësi i QNR-së, thekson se janë verifikuar votat për subjektin PLE, dhe në disa raste vendvotimet janë rinumëruar dhe në raste tjera votat janë shënuar në bazën e të

dhënave sikurse në Formularët e Rezultateve, dhe konstaton se votat të cilat janë në bazën e të dhënave janë të sakta.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet gabimit teknik në Formularët e Përputhjes së Rezultatave, përmes kësaj ankese kërkon rinumërimin e vendvotimeve të reja në kohën kur ende nuk janë certifikuar rezultatet përfundimtare nga KQZ-ja, dhe kështu ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë PZAP-i vlerësoj se ankesa e ankuesit është e palejuar për faktin se PZAP-i nuk mundi të veproj sipas ankesës së ankuesit, në kuptim të nenit të lartëcekur.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ta paraqes sërish ankesën, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.377/2019 më datën 25.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.